

## PROCES VERBAL

### Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë

Tiranë, më 19.11.2020

Me datë 19.11.2020, ora 10.00, me kërkesën dhe nën drejtimin e Zv/Kryetarit të Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi, u zhvillua mbledhja e Këshillit të Gjykatës së Lartë.

Mbledhja e Këshillit të Gjykatës së Lartë, e cila i ishte njoftuar 3 ditë para anëtarëve të Këshillit së bashku me materialet përkatëse, kishte në rend dite çështjet si vijon:

1. Dhënia e statusit të nëpunësit civil gjyqësor të Gjykatës së Lartë.
2. Të ndryshme.

Këshilli i Gjykatës përbëhej nga anëtarët si vijon:

- |                  |   |
|------------------|---|
| 1. Sokol SADUSHI | Zv/Kryetar i Gjykatës së Lartë            |
| 1. Ilir PANDA    | Anëtar Gjykatës së Lartë                  |
| 2. Kelmend GRECA | Përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor |

Të pranishëm në mbledhje e Këshillit të Gjykatës ishin edhe:

- 1) z. B. A., me detyrë specialist i njësisë së burimeve njerëzore;
- 2) z. M. K., me detyrë këshilltar në kabinetin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë;
- 3) zj. V. D., me detyrë sekretare gjyqësore, e ngarkuar për të mbajtur dhe zbardhur proces verbalin audio të mbledhjes.

Në fjalën hyrëse, Zv/Kryetari i Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi, pasi konstatoi prezencën e dy anëtarëve të tjerë të Këshillit, deklaroi të hapur mbledhjen e Këshillit, me rendin përkatës të ditës.

Zv/Kryetari i Gjykatës së Lartë z. Sokol Sadushi sqaroi se meqë për shkak të specifikës që ka Gjykata e Lartë, e cila funksionon prej më shumë se një viti pa kancelar, në përputhje me ligjin dhe aktet nën ligjore përkatëse, të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendin bosh të kancelarit në mbledhjen e Këshillit të Gjykatës, do ta plotësojë nëpunësi civil i nivelit të lartë i caktuar për këtë qëllim nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, z. Klement Greca.

Më pas, Zv/Kryetar i Gjykatës së Lartë z. Sokol Sadushi, theksoi se, në përputhje me rendin e ditës, do të analizohen të gjitha materialet përkatëse që ka përgatitur sektori i burimeve njerëzore lidhur me të gjithë nëpunësit civilë që ka Gjykata e Lartë. Objektivi i mbledhjes është që Këshilli Gjykatës të verifikojë plotësimin ose jo e të gjitha kritereve ligjore të punonjësve me statusin e

nëpunësit civil dhe mbi këtë bazë të merret dhe vendimi përkatës për akordimin e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, sipas parashikimeve ligjore. Për këtë qëllim, sektori i burimeve njerëzore ka përgatitur materialin përkatës për çdo nëpunës, së bashku me drejtoreshën e kabinetit zj. A.V. dhe këshilltarin z. M. K.

Mbas dhënies së fjalës, specialisti i burimeve njerëzore z. B. A. në mënyrë të përmbledhur paraqiti një ekspozitë të dhënave të punonjësve që janë aktualisht në detyrë, të cilët plotësojnë kriteret ligjore (të përgjithshme e të veçanta) për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor pranë Gjykatës së Lartë, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur prej tyre.

Mbasi diskutoi materialin e përgatitur nga sektori i burimeve njerëzore, Këshilli u ndal në veçanti dhe te tre problematika që rezultuan dhe që kishin të bënin me: (1) statusin e Kancelarit të Gjykatës së Lartë, z. Agim Gogu; (2) statusin e specialistit të burimeve njerëzore, z. B. A., dhe (3) statusin e 4 (katër) specialistëve të cilët ishin emëruar apo ngritur në detyrë para hyrjes në fuqi të vendimit të KLGJ për pezullimin e procedurave të emërimit apo ngritjes në detyrë të nëpunësve civile gjyqësore në gjykata.

Lidhur me çështjen e parë, Këshilli i Gjykatës, pasi shqyrtoi statusin juridik të z. Agim Gogu dhe dëgjoi pretendimet e tij, vendosi që t'i akordojë atij statusin e nëpunësit civil gjyqësor në nivelin e specialistit pranë sektorit të marrëdhënieve me publikun, media dhe bibliotekën, por duke vazhduar ushtrimin e përkohshëm të detyrës së kancelarit, me pagën e specialistit, deri në një vendimmarrje të KLGJ për zgjidhjen e çështjes së marrjes së pagës si kancelar, problem i cili është konstatuar dhe në disa gjykata të tjera.

Lidhur me çështjen e dytë, Këshilli, në kushtet kur konstatoi se specialisti i burimeve njerëzore B.A., e ka mbushur moshën e pensionit të pleqërisë, vendoi të mos i akordojë atij statusin e nëpunësit civil gjyqësor, por për nevojën punës, ai të vijojë ushtrimin e detyrës, deri në momentin e rekrutimit të nëpunësit të ri zëvendësues.

Lidhur me çështjen e tretë, Këshilli pasi diskutoi situatën ligjore të emërimit të 4 (katër) nëpunësve civilë (rekrutimi i punonjësve R. P. në sekretarinë gjyqësore, dhe K. K. në sektorin e marrëdhënieve me median, publikun dhe bibliotekën, si dhe ngritjen në detyrë të specialistes T. N. në nivelin e përgjegjësës së sektorit të administrimit gjyqësor dhe specialistit I. U. Në nivelin e përgjegjësimit të sektorit sigurisë), konkludoi se këtyre nëpunësve duhet t'u akordohet statusi i nëpunësit civil gjyqësor, për shkak se, meqë të gjithë punonjësit e tjerë janë rekrutuar, sipas ligjit për statusin e nëpunësit civil, njëjloj si këta 4 punonjës, dhe për sa kohë jemi në kushtet e zbatimit të dispozitave tranzitore, atëherë kjo mjafton për të ligjëruar vendimmarrjen e Këshillit të Gjykatës për konfirmimin e tyre në detyrë dhe dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor të këtyre 4 nëpunësve.

Në përfundim, Këshilli i Gjykatës akordoi me votë unanime statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë për 33 nëpunës të Gjykatës (4 përgjegjës sektori dhe 29 specialistë sektori).